



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 669 Akti

Nr. 490 Vendimi  
Tiranë, më 20.12.2021

### V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Etleda Çiftja</b>	Kryesuese
<b>Brunilda Bektoshi</b>	Relatore
<b>Lulzim Hamitaj</b>	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, njoftuar dhe konfirmuar në mënyrë elektronike në datën 16.12.2021, nga vëzhguesi ndërkombëtar, znj. Marie Tuma, në datën 20.12.2021, mori në shqyrtim çështjen që i përket,

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Erida Kokonozi (Lamka)**, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Aneksi i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

### **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Brunilda Bektoshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të administruara, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Erida Kokonozi, me funksion prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur më 15.12.2020, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

2. Me vendimin nr. 1, datë 21.12.2020, trupi gjykues shprehu mospasjen e konfliktit të interesit, si dhe caktoi kryesues komisioneren, znj. Etleda Çiftja.

3. Me emailin e datës 11.2.2021 subjekti u njoftua me përbërjen e trupit gjykues, për të cilin deklaroi<sup>1</sup> se nuk është në konflikt interesi me anëtarët e tij.

4. Komisioni, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 1.11.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, është vënë në dijeni se subjekti i rivlerësimit ka ndërruar jetë në datën 28.10.2021. Ky fakt është konfirmuar edhe me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.12.2021 të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, bashkëlidhur së cilës ndodhet certifikata e vdekjes së të ndjerës, znj. Erida Kokonozi (Lamka).

### ARSYETIMI I KOMISIONIT

6. Subjekti i rivlerësimit, znj. Erida Kokonozi, me funksion prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligjit, ka dërguar dhe plotësuar, si vijon:

- a. deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, në ILDKPKI, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31 të tij;
- b. deklaratën për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35 të tij;
- c. formularin e vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr.84/2016, sipas nenit 41 të tij.

7. Komisioni, pas fillimit të procedurës së rivlerësimit, në kushtet kur subjekti ka ndërruar jetë, çmon se duhet të përfundojë këtë procedurë pa një vendim përfundimtar në bazë dhe për zbatim:

- a. të nenit 90/3 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se: “*Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi*”,
- b. të nenit 93/1 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet: “*Nëse pala, person fizik, vdes gjatë zhvillimit të procedurës administrative që zhvillohet për një çështje të karakterit personal, organi publik*

---

<sup>1</sup> me e-mailin e datës 1.2.2021.

*deklaron të përfunduar procedurën administrative, pa marrë një vendim përfundimtar për çështjen”.*

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, bazuar në nenet 90 dhe 93 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenin 64 të ligjit nr. 94/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë përfundimin e procesit të rivlerësimit pa një vendim përfundimtar për subjektin e rivlerësimit, Erida Kokonozi (Lamka).
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 20.12.2021.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Etleda Çiftja**  
**Kryesuese**

**Lulzim Hamitaj**  
**Anëtar**

**Brunilda Bekteshi**  
**Relatore**

*Sekretare gjyqësore*  
*Denisa Kosta*